

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 4-2021

KOSOVA DHE POLITIKA E IBRAHIM RUGOVËS

Fiolla Zeqiri

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Political Science Commons](#)

Recommended Citation

Zeqiri, Fiolla, "KOSOVA DHE POLITIKA E IBRAHIM RUGOVËS" (2021). *Theses and Dissertations*. 2597.
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2597>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

KOSOVA DHE POLITIKA E IBRAHIM RUGOVËS
Shkalla Bachelor

Fiolla Zeqiri

Prill/2021
Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

Punim Diplome
Viti akademik 2017/18

Fiolla Zeqiri

KOSOVA DHE POLITIKA E IBRAHIM RUGOVËS

Mentori: Hajdi Xhixha

Prill/2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Synimi i këtij punimi bachelor është trajtimi i çështjes së Kosovës gjatë udhëheqjes së Dr.Ibrahim Rugovës. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka 120 anëtarë të zgjedhur për një mandat katër vjeçar. Sipas Kushtetutës, Kosova do të ketë një kuvend të përbërë nga 120 anëtarë. Kosova ka një sistem shumëpartiak, me parti të shumta në të cilat asnjë parti shpesh nuk ka shanse të fitojë pushtet, dhe partitë duhet të punojnë me njëra-tjetrën, për të formuar qeveritë e koalicionit. Ky punim përmban ecurinë e ngjarjeve kryesore duke filluar me Presidenti Ibrahim Rugova – cili ishte bashkëthemelues i Lidhjes Demokratike të Kosovë e cila ishte lëvizja e parë demokratike gjithë popullore në Kosovë që udhëhoqi popullin e Kosovës drejt rrugës për Liri, Pavarësi e Demokraci dhe që më vonë do të transformohej në Parti Politike dhe Rugova ishte kryetar i saj, që nga themelimi i saj më 23 dhjetor të vitit 1989 deri më 21 janar të vitit 2006, kur ndërroi jetë. Për shkak të rolit të tij në historinë e Kosovës, Rugova është quajtur "Ati i Kombit" dhe "Gandi i Ballkanit", ndërsa pas vdekjes është shpallur Hero i Kosovës. Kjo periudhë shënon kohën gjatë, së cilës Kosova e përvetësoi mjaftueshëm demokracinë. Elementet kyçe të demokracisë filluan të zbatohen plotësisht dhe sipas standardeve ndërkombëtare në Kosovë—zgjedhjet e lira dhe të drejta, themelimi dhe funksionimi i institucioneve të sundimit të ligjit, liria e fjalës, transferi i pushtetit nga një parti tek tjetra, ekonomia e tregut të lirë, etj. Demokracia ishte praktikuar në Kosovë edhe para 1999-tës, por pa legjitimitet ndërkombëtar.

Fjalët kyçe: *Dr.Ibrahim Rugova, Republika e Kosovës, historia, themelimi, liria dhe e drejta, funksionimi, demokracia.*

MIRËNJOHJE DHE FALENDERIME

Punimi i temës së diplomës, i cili u përfundua me mund dhe përkushtim të madh, nuk mund të realizohej pa përkrahjen e njerëzve më të dashur, prandaj ju jam mirënjohese dhe i falenderoj pafund familjen time dhe mentorin e temës Hajdi Xhixha, që më kanë mbështetur jo vetëm tani por për gjatë gjithë rrugëtimit tim studentor.

PËRMBAJTJA

1. Hyrje	1
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS	2
2.1.1. Politika në Kosovë	2
2.1.2. Qeveria e Kosovës	3
2.1.3 Ekzekutivi	4
2.1.4. Legjislacioni.....	4
2.1.5. Autonomia dhe pavarësia.....	4
2.1.6. Sistemi Politik	6
2.2. Ibrahim Rugova	7
2.2.1. Humanist i bindur me një anë profetike.....	13
2.2.2. Ndalimi, largimi dhe rikthimi në triumf.....	14
2.3. Bota dhe Dr. Ibrahim Rugova dhe trinomi: Liri, Pavarësi dhe Demokraci	15
2.3.1. Liri (1989-1999).....	16
2.3.2. Demokraci (1999-2008).....	17
2.3.3. Pavarësia (2008-2019)	17
2.4. Dr. Ibrahim Rugova dhe ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës dhe më gjerë, asaj shqiptare në Ballkan	19
2.4.1. Filozofia politike dhe nacionale e Ibrahim Rugovës.....	20
2.5. Kosova si subjekt i ri në politikë.....	25
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT	28
4. METODOLOGJIA	29
5. PËRFUNDIME	30
BIBLIOGRAFIA	32

1. Hyrje

Në kapitullin e parë është trajtuar dimensionin teorik i mënyrës së organizimit të Kosovës si një Republikë parlamentare dhe shtet modern demokratik i cili mbështetet në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, gjë që e përcakton edhe vetë Kushtetuta e shtetit. Shqiptarët etnikë përbëjnë shumicën e popullsisë, ndërsa Kushtetuta garanton që komunitetet tjera jo-shqiptare të gëzojnë të drejta të barabarta me shumicën e popullsisë vendase dhe të luajnë një rol të rëndësishëm, në disa raste vendimtarë në çështje të drejtimit të shtetit, nëpërmjet të drejtës kushtetuese për shumicë të dyfishtë. Në kapitullin e dytë janë analizuar momentet kryesore të procesit diplomatik të përpjekjeve ndërkombëtare për definimin e statusit të Kosovës. Vizioni i tij ishte mjaft i qartë, shumë i vendosur dhe për këtë së shpejti ishte shndërruar në lider, udhërrëfyes dhe vizionar në nivelin popullor, tek intelektualët, tek rinia, me paraqitje dinjitoze dhe të qeta, njëkohësisht të vendosura dhe parimore, por edhe të argumentuara dhe paqësore. Në kapitullin e tretë, është analizuar shkurtimisht përfshirja praktike e Kosovës në kuadër të mekanizmave dhe nismave të Ibrahim Rugovës. Trinomi: Liri, Pavarësi dhe Demokraci pa dyshim ishte filozofia dhe përcaktimi i tij politik dhe jetësor. Këtë e kanë cekur edhe autorët dhe studiuesit tanë dhe të huaj. Thelbi i lëvizjes së Rugovës për çlirim ishte mospërdorimi i dhunës. Para së gjithash kjo strategji kërkonte vetëdije të plotë politike, vetëbesim, si dhe përgaditje psikologjike, shpirtërore, sociale e shoqërore të njerëzve që e përfaqësonin. Në kapitullin e katërt janë analizuar perspektivat e ardhshme të Kosovës të bashkëpunimit rajonal në funksion të integritimit në BE. Synimet dhe sfidat që e presin Kosovën në këtë proces të ardhshëm të Kosovës në bashkëpunimin rajonal me vendet fqinje. Kosova si subjekt i ri në politikën ndërkombëtare, është përballur me suksese dhe sfida të shumta. Duke qenë se Republika e Kosovës, nuk ka pasur përvojë e kuadro të mjaftueshme diplomatike dhe të politikës së jashtme, është nevojitur që politika e jashtme të ndërtohet nga bazat e saj.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Ky hulumtim është ndarë në disa pjesë që të na ndihmojë ta kuptojmë më mirë punimin. Duke përdorur literaturë nga burime të ndryshme, ka ndihmuar që punimi të shtjellohet sa më rrjedhshëm dhe në mënyrë sa më të qartë. Poashtu, punimi përmban literaturë nga autorë të huaj si dhe burime të ndryshme nga interneti.

2.1.1. Politika në Kosovë

Politika e Kosovës zhvillohet në një kornizë të një republike demokratike përfaqësuese parlamentare shumëpartiake, ku presidenti është kreu i shtetit dhe kryeministri është kreu i qeverisë. Zgjedhjet parlamentare mbahen çdo katër vjet, më të fundit në 2019-ën. Pushteti ekzekutiv ushtrohet nga qeveria, e kryesuar nga kryeministri. Pushteti legjislativ i është dhënë si ekzekutivit ashtu edhe kuvendit. Gjyqësori është i pavarur nga pushteti ekzekutivi dhe ai ligjvënës. Kushtetuta e Kosovës është baza e Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Kaçanikut e cila është nxjerrë nga ish Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës më 10 shtator 1990, është e bazuar në Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës, të shpalluar më 2 korrik 1990. Kosova fillimisht ishte nën udhëheqjen e **Misioni i Organizatës Kombeve të Bashkuara në Kosovë - UNMIK** ku në bazë të Rezolutës 1244 është nën Protektoriatin (Administrimin civil, politik dhe ushtarak) të Këshillit Sigurimit të **Organizatës Kombeve të Bashkuara**, çka nënkupton Administrim të përkohshëm të Kosovës nga kjo organizatë e cila këtë e bënë me Misionin e saj në Kosovë të njohur me shkurtesën **UNMIK**.

Misioni i Organizatës Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) udhëhiqej nga Autoriteti i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të **OKB-së**. Mirëpo, me kalimin e kohës UNMIK-u kishte për detyrë dhe i ndihmoi vendorët në krijimin e Institucioneve të Përkohëshme Vetqeverisëse të Kosovës, së pari me formimin e Këshillit Përkohshëm Administrativ, ku ishin të përfaqësuar të gjitha grupet politike dhe bashkësitë etnike që jetojnë në Kosovë. Më vonë u nxor Korniza Kushtetuese të Kosovës, dokument i cili është miratuar me konsensus në mes të strukturave ndërkombtare dhe UNMIK-ut në një rën anë dhe atyre vendore. Në bazë të *Kornizës Kushtetuese* fillon ndërtimi i institucioneve vendore si dhe funksionalizimi dhe demokratizimi i

tyre nën mbikqyrjen ndërkombëtare. Njihet e drejta për krijimin e institucioneve vetëqeverisëse, si ato qendrore ashtu edhe lokale, përmes zgjedhjeve të lira dhe votës së lirë të qytetarëve për të dy nivelet e pushtetit. Që nga viti 2000, Kosova me sukses ka mbajtur katër palë zgjedhje demokratike (dy herë zgjedhjet qendrore dhe dy herë zgjedhjet lokale). Këto zgjedhje janë vlerësuar nga organizatat ndërkombëtare monitoruese si zgjedhje demokratike, të lira dhe të drejta. Përmes këtyre zgjedhjeve, Kosova i ka formuar institucionet e saja demokratike qendrore dhe lokale, të cilat janë plotësisht funksionale: Parlamentin me 120 vende (20 të rezervuara për pakicat etnike), Presidencën, Qeverinë, kuvendet komunale dhe ekzekutivin në nivel lokal (*Ferja 2004: fq. 14-15*).

2.1.2. Qeveria e Kosovës

Qeveria e Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe me ligjin. Qeverinë e Kosovës e përbëjnë kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat. Qeveria udhëhiqet nga kryeministri/ja, ai ose ajo zgjidhet nga Kuvendi i Kosovës. Qeveria zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe ushtron veprimtari tjera brenda përgjegjësive të përcaktuara me këtë Kushtetutë dhe me ligj. Qeveria merr vendime në pajtim me këtë Kushtetutë dhe me ligje, propozon projektligje dhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese e akteve të tjera, si dhe mund të japë mendimin rreth projektligjeve të cilat nuk janë të propozuara nga ajo. Qeveria, për punën e vet, i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.

Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat mbajnë bashkëpërgjegjësinë për vendimet që merr qeveria, dhe përgjegjësinë individuale për vendimet, që marrin në fushat e përgjegjësive të tyre. Ministrat nominohen nga kryeministri dhe pastaj votohen nga kuvendi. (*Ferja 2004: fq. 15*).

Qeveria ka këto kompetenca:

- propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;
- mundëson zhvillimin ekonomik të vendit;

- propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera;
- merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve;
- propozon Buxhetin e Republikës së Kosovës;
- udhëzon dhe mbikqyrë punën e organeve të administratës;
- udhëzon veprimtarinë dhe zhvillimin e shërbimeve publike;
- i propozon Presidentit të Republikës së Kosovës emërimet dhe shkarkimet për shefa të misioneve diplomatike të Kosovës;
- propozon amendamentimin e Kushtetutës;
- mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese;
- ushtron edhe funksione të tjera ekzekutive, të cilat nuk u janë caktuar organeve të tjera qendrore;

2.1.3 Ekzekutivi

Ekzekutivi i Kosovës është koleksioni i institucioneve të Kosovës, që ushtrojnë autoritetin ekzekutiv në Kosovë. Ajo drejtohet nga kryeministri i Kosovës, dhe gjithashtu përfshin kryeministrin, zëvendëskryeministrat dhe ministrat e ndryshëm.

2.1.4. Legjislacioni

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka 120 anëtarë të zgjedhur për një mandat katër vjeçar. Sipas Kushtetutës, Kosova do të ketë një kuvend të përbërë nga 120 anëtarë. Ai përfshin njëzet vende të rezervuara, të cilat janë dhjetë për serbët e Kosovës dhe dhjetë për pakicat jo-serbe (p.sh, boshnjakët, romët etj.). Kosova ka një sistem shumëpartiak, me parti të shumta, në të cilat asnjë parti shpesh nuk ka shanse të fitojë pushtet, dhe partitë duhet të punojnë me njëra-tjetrën për të formuar qeveritë e koalicionit. Kuvendi miraton të gjitha ligjet në Kosovë, ratifikon traktatet ndërkombëtare, emëron presidentin, kryeministrin, ministrat dhe gjyqtarët e të gjitha gjykatave, miraton buxhetin dhe kryen detyra të tjera të përcaktuara me Kushtetutë. Parlamenti mund të kalojë një votë mosbesimi ndaj qeverisë nga shumica e anëtarëve.

2.1.5. Autonomia dhe pavarësia

Rajoni Autonom i Kosovës dhe Metohisë (1945-1963) u krijua në vitin 1945 si një entitet autonom në Republikën Socialiste të Serbisë. Sipas kushtetutës së vitit 1974, Kosova fitoi një autonomi të gjerë dhe u bë një nga subjektet e federatës jugosllave. Më 5 korrik 1989, kjo autonomi e gjerë u revokua nga administrata e Sllobodan Millosheviçit dhe sasia e autonomisë së Kosovës ishte rikthyer në statusin e saj para vitit 1974. Më 28 shtator 1990, emri i krahinës iu kthye Provincës Autonome të Kosovës dhe Metohisë.

Në vitin 1990, Kosova u shpall e pavarur nga politikanët etnikë shqiptarë dhe u njoh nga Shqipëria. Emri i entitetit ishte Republika e Kosovës. Një periudhë luftimesh e ndjekur midis shqiptarëve të Kosovës dhe forcave të sigurisë jugosllave, që rezultoi në një krizë humanitare. Në vitin 1999, Kombet e Bashkuara vendosën Kosovën nën administrimin e tyre pas luftës në Kosovë. Sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) u krijua më 10 qershor 1999, i cili mbajti mënyrën se si funksiononte Provinca e Kosovës. Rezoluta 1244 bëri thirrje për një proces politik për të përcaktuar statusin e ardhshëm të Kosovës; Bisedimet e sponsorizuara nga OKB-ja filluan në vitin 2006. Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara e vendosi Kosovën nën administrimin kalimtar të OKB-së në pritje të përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës. Kjo rezolutë i besoi UNMIK-ut kompetenca gjithëpërfshirëse për të qeverisur Kosovën.

Rezoluta 1244 nuk i dha Jugosllavisë asnjë rol në qeverisjen e Kosovës dhe që nga viti 1999, ligjet dhe institucionet nacionale nuk ishin të vlefshme në Kosovë. Rezoluta njohu sovranitetin jugosllav të Kosovës. NATO ka një mandat të veçantë për të siguruar një mjedis të sigurt. Në maj 2001, UNMIK-u shpalli Kornizën Kushtetuese, e cila themeloi Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ). Pas vitit 2001, UNMIK-u gradualisht transferoi kompetencat qeverisëse në IPVQ, ndërsa rezervoi disa kompetenca siç janë punët e jashtme.

Kosova gjithashtu themeloi qeveri komunale dhe një Shërbim Policie të Kosovës të mbikëqyrur ndërkombëtarisht. Partia më e madhe politike në Kosovë, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e ka origjinën e saj në lëvizjen rezistuese jo të dhunshme të viteve 1990 kundër sundimit të Millosheviçit. Partia drejtohej nga Ibrahim Rugova deri në vdekjen e tij në vitin 2006. Dy partitë e ardhshme më të mëdha i kanë rrënjët në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK): Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e udhëhequr nga ish-udhëheqësi i UÇK-së Hashim Thaçi dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e udhëhequr nga ish-komandanti i UÇK-së Ramush Haradinaj. Botuesi kosovar Veton Surroi formoi partinë e tij politike në 2004 me emrin "Ora".

Serbët e Kosovës formuan Listën Serbe për Kosovën dhe Metohinë (SLKM) në vitin 2004, por kanë bojkotuar institucionet e Kosovës dhe kurrë nuk kanë zënë vendet në Kuvendin e Kosovës.

2.1.6. Sistemi Politik

Sistemi Politik në Kosovë; Kosova si një Republikë parlamentare dhe shtet modern demokratik mbështetet në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, gjë që e përcakton edhe vetë Kushtetuta e shtetit. Shqiptarët etnikë përbëjnë shumicën e popullsisë, ndërsa Kushtetuta garanton, që komunitetet tjera jo-shqiptare të gëzojnë të drejta të barabarta me shumicën e popullsisë vendase dhe të luajnë një rol të rëndësishëm, në disa raste vendimtarë në çështje të drejtimit të shtetit, nëpërmjet të drejtës kushtetuese për shumicë të dyfishtë. Institucionet Kryesore të Kosovës janë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, i përbërë nga 120 deputetë dhe ushtron pushtetin legjislativ. Në kuadër të kësaj ndarjeje, njëzet (20) prej njëqind e njëzet (120) vendeve janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve, që nuk janë shumicë në Kosovë.

Presidenti i vendit përfaqëson unitetin e popullit, është përfaqësues legjitim brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës. Qeveria është organi tjetër përgjegjës për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe i nënshtrohet kontrollit parlamentar, ndërsa, pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga Gjykatat. Kushtetuta e Kosovës u siguron pjesëmarrje të gjitha komuniteteve jo-shumicë në qeveri, me së paku tre poste ministrore dhe pesë poste të zëvendës-ministrave dhe poste të tjera sipas marrëveshjeve respektive të partive politike që bëjnë koalicione për të qeverisur me vendin. Koncepti qytetar dhe civil, barazia qytetare dhe të drejtat e njeriut, karakteri shumë-etnik, mbrojtja e veçantë e të drejtave të komuniteteve, që jetojnë në Kosovë/diskriminimi pozitiv apo laiciteti dhe neutraliteti ndaj çështjeve të besimeve fetare dhe mos ndalimi i martesave të gjinisë së njëjtë vlerësohen si disa nga tiparet më të avancuara dhe përparimtare të aktit më të lartë juridik në Kosovë, Kushtetutës.

Gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës janë gjuha Shqipe dhe gjuha Serbe, ndërsa gjuhët Turke, Boshnjake dhe ajo Rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në nivel komune. Për shkak të prezencës së madhe të ndërkombëtarëve, gjuha angleze ka përdorim relativisht të madh. Lidhjet tjera të forta me shtetet evropiane, për shkak të prezencës së madhe të diasporës së Kosovës në shtetet evropiane dhe mosha shumë e re në vend i kanë dhënë një shtytje të fortë edhe përdorimit të gjuhëve të tjera, në veçanti asaj gjermane. Republika e Kosovës ka edhe institucionet e veta për mbrojtjen e rendit

kushtetues, integritetit territorial, rendit dhe qetësisë publike, të cilat funksionojnë nën autoritetin kushtetues të institucioneve demokratike të Republikës së Kosovës.

Institucionet e Sigurisë në Kosovë të themeluara sipas standardeve dhe praktikave më të avancuara ndërkombëtare dhe sipas organizatave kredibile vlerësohen si ndër më të mirat në rajon. Kosova ka 38 Komuna, nga të cilat dhjetë sish, që kanë shumicë të popullatës serbe udhëhiqen nga komuniteti serb, ndërsa një nga pakica turke, që jeton në Kosovë. Megjithëse një vend i vogël, llogaritet se në Kosovë janë mbi 30 parti politike dhe më shumë se 50 iniciativa qytetare. Kosova e lejon edhe shtetësinë e dyfishtë.

2.2. Ibrahim Rugova

Ibrahim Rugova- (2 dhjetor 1944 – 21 janar 2006)- ishte Presidenti i parë i Republikës së Kosovës, duke shërbyer në vitet 1992–2000 dhe përsëri në vitet 2002–2006 ishte intelektual, politikan, akademik dhe shkrimtar shqiptar. I lindur në Cerrce, Kosova perëndimore, në 1944, ky intelektual i shkolluar në Sorbonë i përkiste elitës kulturore të Prishtinës që erdhi në moshë në fund të viteve 1960 dhe që ishte aktive gjatë viteve tetëdhjetë. Gjatë viteve tetëdhjetë, kjo elitë intelektuale, e

përbërë kryesisht nga gazetarë, akademikë dhe shkrimtarë, filloi të rimendojë shoqërinë kosovare pas viteve të gjata të qeverisjes së Presidentit Tito. Rebelimi në vitin 1981, me kërkesën e saj që Kosova të gëzonte statusin e republikës brenda federatës Jugosllave, shkaktoi kërkesa nga Beogradi për statusin autonom të Kosovës brenda Jugosllavisë që të kalonte në shtrat. Si president i Kosovës në ballë të Shoqatës së Shkrimtarëve, Rugova ishte Shkrimtari. Përkundër kësaj platforme ai mbante titullin Doktor. Presidenti Ibrahim Rugova ishte bashkëthemelues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, e cila ishte lëvizja e parë demokratike gjithë popullorë në Kosovë që udhëhoqi popullin e Kosovës drejt rrugës për liri, pavarësi e demokraci dhe që më vonë do të transformohej në Parti Politike dhe Rugova ishte kryetar i saj që nga themelimi i saj më 23 dhjetor të vitit 1989 deri më 21 janar të vitit 2006 kur ndërroi jetë (*Krasniqi 2017: fq. 1-3*).

Ai udhëhoqi një luftë popullore për pavarësi, që avokoi një rezistencë paqësore ndaj sundimit jugosllav dhe lobi për mbështetje nga SHBA-të dhe Evropa, veçanërisht gjatë Luftës së Kosovës. Ai theksoi fort trashëgiminë e lashtë të Dardanisë, mbretëri e pavarur dhe më vonë provincë e Perandorisë Romake që përfshinte territorin e sotëm të Kosovës, për të forcuar identitetin e vendit dhe për të promovuar politikën e tij të marrëdhënive të ngushta me Perëndimin. Ishte studiues dhe krijues burimor, njohës i thellë i traditës dhe kulturës sonë të lashtë, kritik letrar me aftësi të rralla shkoqitëse, njohuri të sakta, stil elegant, qëndrime gjithnjë pozitive dhe optimiste për kontekstin shoqëror dhe hapësinor shqiptar. Mbi të gjitha ishte strategu i politikës paqësore, do të thoja edhe më tepër, Profeti i Paqes, Gandi i ditëve tona në dimensione kombëtare dhe ndërkombëtare, njeri i cili shkencën, kulturën, artin, jetën e vuri në shërbim të politikës, ndërsa politikën në shërbim të së mirës së përbashkët, duke dëshmuar kështu një stil të ri tejet human të politikës paqësore dhe jodhunore. Shpesh thoshte: *“Politika nuk është matematikë”* duke menduar dhe theksuar se njeriu nuk është kurrë vetëm numër, por person, individ i pacenueshëm, dhe se pakica dhe shumica duhet të bashkëpunojnë gjithnjë në kërkimin dhe zbatimin e paqes.

Pastaj vazhdonte: *“Arma jonë e fuqishme është lashtësia, tradita, kultura, rrënjët dhe identiteti ynë, si dhe rinia jonë...”* *“Ne duam dhe kërkojmë mënyra demokratike që t’na pranojnë për atë çka jemi e pa e dëmtuar askënd... Nëse ne do ta mposhtim urrejtjen, ndarjet dhe pëprçarjet, sidomos traditën e gjak apo hak-marrjes, atëherë do të jemi të lirë dhe popull demokratik... Intelektualët shqiptarë duan të jenë në shërbim të popullit... Çka na duhet Kosova e përgjysmuar nga masakrimet apo përjashtimet... Tani është e rëndësishme ta shpëtojmë poullin. Do të kërkojmë prej bashkësisë ndërkombëtare një fazë kalimtare, protektoratin ndërkombëtar për disa vite, e pastaj*

do të punojmë së bashku për pavarësinë e Kosovës... Në mua kanë ndikuar shumë pozitivisht dy personalitete botërore, Papa Gjon Pali II dhe Nëna Tereze...". Për shkak të rolit të tij në historinë e Kosovës, Rugova është quajtur "Ati i Kombit" dhe "Gandi i Ballkanit", ndërsa pas vdekjes është shpallur Hero i Kosovës. Ibrahim Rugova shkollën fillore e kreu në Istog, të mesmen e kreu në Pejë, më 1967. Fakultetin Filozofik – Dega Gjuhë e Letërsi Shqipe e kreu në Prishtinë. Gjatë vitit akademik 1976-77 qëndroi në Paris, në École Pratique des Hautes Études, nën mbikëqyrjen e Prof. Roland Barthes-it, ku ndoqi interesimet e veta shkencore në studimin e letërsisë, me përqendrim në teorinë letrare. Doktoroi në fushën e letërsisë në Universitetin e Prishtinës, më 1984. Në vitin 1996 Ibrahim Rugova u zgjodh anëtar korrespondent i Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës. Në fillim ishte redaktor në gazetën e studentëve Bota e re dhe në revistën shkencore Dituria (1971-72), që botoheshin në Prishtinë. Një kohë punoi edhe në revistën Fjala.

Për afro dy dekada, Ibrahim Rugova veprimtaritë e veta shkencore i zhvilloi në Institutin Albanologjik si hulumtues i letërsisë. Një kohë ka qenë kryeredaktor i revistës Gjurmime albanologjike të këtij Instituti. Me krijimtari letrare u mor që nga fillimi i viteve gjashtëdhjetë. Ibrahim Rugova më 1988 u zgjodh kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, që u bë bërthamë e fuqishme e lëvizjes shqiptare, e cila kundërshtoi sundimin komunist serb dhe jugosllav në Kosovë.

Me frymëzimin e një misionari ai kishte bindur njerëzit për një ëndërr të re, të bukur, por larg ëndrrës shekullore të shqiptarëve, bashkimit. Që prej vitit 1912 kjo fjalë kishte qenë gjithçka. Patriotët, politikanët, gazetarët, njerëzit e letrave, por edhe ata më të thjeshtët kishin folur vetëm për këtë gjë, kishin pasur vetëm këtë ëndërr, bashkimin. Bashkimin e Kosovës me trungun amë, me atdheun, Shqipërinë. Rugova kish ecur në një rrugë tjetër: nuk kishte folur për bashkim, për unifikim, për ndryshime kufijsh apo diçka tjetër. Kish ngritur kultin e Kosovës së pavarur dhe shtetit të saj, duke krijuar kështu një ëndërr të re, një ëndërr që fati e solli të bëhej realitet ende në gjallje të tij. Dhe ai pati fatin të ishte Presidenti i parë i Kosovës (*Harapi 2018*).

Si intelektual që i jepte zë kësaj lëvizjeje intelektuale e politike Ibrahim Rugova u zgjodh, më 23 dhjetor 1989, nga themelimi kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, partisë së parë politike në Kosovë që sfidoi drejtpërdrejtë regjimin komunist në fuqi. LDK, nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës, u bë shpejt forca politike prijëse në Kosovë, duke mbledhur shumicën e popullit rreth vetes. Në bashkëpunim me forcat e tjera politike shqiptare në Kosovë si dhe me Kuvendin e

atëhershëm të Kosovës, Ibrahim Rugova dhe LDK-ja përmyllën kornizën ligjore për institucionalizimin e pavarësisë së Kosovës.

Deklarata e pavarësisë (2 korrik 1990), shpallja e Kosovës Republikë dhe miratimi i kushtetutës së saj (7 shtator 1990), referendumi popullor për pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës, mbajtur në fund të shtatorit 1991, qenë prelud për zgjedhjet e para shumëpartiake për Kuvendin e Kosovës, mbajtur më 24 maj 1992. Ibrahim Rugova u zgjodh President i Republikës së Kosovës. Ibrahim Rugova u rizgjodh President i Republikës së Kosovës në zgjedhjet e mbajtura në mars të vitit 1998 (*Bytyqi 2010: fq. 12-23*).

Nën udhëheqjen e Ibrahim Rugovës LDK-ja fitoi shumicën e votave në zgjedhjet e para lokale të sponsorizuara ndërkombëtarisht në Kosovën e pasluftës në tetor të vitit 2000 si dhe në zgjedhjet e para nacionale në vitin 2001 dhe në zgjedhjet e dyta lokale të vitit 2002. LDK fitoi edhe zgjedhjet e fundit nacionale më 2004. Ibrahim Rugova vdiq më 21 janar 2006, u varros me nderime të larta shtetërore dhe ushtarake. Funerali i Ibrahim Rugovës ishte njëri nga më të mëdhenjtë të historisë shqiptare. Në përvjetorin e vdekjes së Ibrahim Rugovës, më 21 janar 2007 Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, dekoroi Presidentin historik të Kosovës me Urdhërin “Hero i Kosovës”, titulli më i lartë në vendin tonë që u jepet figurave historike shqiptare dhe të Kosovës që kanë bërë “vepra trimërie për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës”.

Më 23 dhjetor 1989 kur në ish-Republikën Socialiste Federative e Jugosllavisë mori fund sundimi njëpartiak i Lidhjes së Komunistëve, Rugova dhe një grup intelektualësh të tjerë shqiptarë të Kosovës themeluan një parti të re, Lidhjen Demokratike të Kosovës, LDK. Ai u zgjodh kryetar i partisë në ditën e saj të parë, një post të cilin e mbajti për më shumë se 16 vjet deri në vdekjen e tij. Në maj të vitit 1992, shqiptarët e Kosovës organizuan një votim jozyrtar për një president dhe parlament, të cilin autoritetet e atëhershme serbe e shpërfillën. Rugova u zgjodh president, por parlamenti i zgjedhur në këto zgjedhje nuk u bë kurrë funksional.

Në vitin 1998, pati një raund tjetër zgjedhjesh që u kundërshtuan më shumë nga rivalët politikë për shkak të kohës. Këto zgjedhje u mbajtën pasi pjesë të Kosovës, sidomos rajoni i Drenicës, ishin vënë në shënjestër të policisë serbe, më pak se tre javë pasi forcat serbe kishin vrarë Adem Jasharin, një komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, UÇK. Jashari u vra së bashku me 58 të afërm të tij në një betejë tre-ditore. Roli i Rugovës në formësimin e shoqërisë kosovare ishte vendimtar në zhvillimet e mëtejshme në rajon. Për më shumë se dhjetë vjet ai homogjenizoi popullsinë e

Kosovës rreth idesë së pavarësisë, emancipoi politikën kosovare duke e orientuar atë drejt vlerave perëndimore dhe ndërkombëtarizoi çështjen e Kosovës (*Nurboja 2018: fq. 14-22*).

Konceptet shoqërore politike u frymëzuan nga etërit themelues të Amerikës dhe lufta amerikane për pavarësi dhe kombinimi i liberalizmit social dhe vlerave tradicionale nga SH.B.A. Ai gjithashtu u ndikua nga vlerat e Revolucionit Francez. Në atë kohë ai do të thoshte shpesh se edhe pse fillimi i një konflikti të armatosur do të ishte i lehtë, ai do të ishte gjithashtu joproduktiv jashtë vendit. "Kosova ka nevojë për miq që do të shkaktojnë," tha mbështetja Rugova. Në të vërtetë, marrja e mbështetjes ndërkombëtare për çështjen e Kosovës ishte shtylla kryesore e strategjisë së tij. Ai arriti të fitojë mirënjohje dhe u mor nga shumë krerë shtetesh dhe qeverie dhe ministra të jashtëm në SH.B.A dhe Evropë. Ai i kushtoi vëmendje të veçantë ndërkombëtare marrëdhënieve me SH.B.A., vendet e BE dhe Vatikanin, duke shijuar marrëdhënie të përzemërta me Papën Gjon Pali II. Platforma e këtij këshilli do të bëhej orientimi kryesor për zgjidhjen e çështjes shqiptare në ish Jugosllavi gjatë dhjetë viteve të ardhshme. Pikat kryesore ishin pavarësia e Kosovës, statusi i kombit përbërës për shqiptarët në Maqedoni autonomia për shqiptarët në Luginën e Preshevës në Serbinë jugore dhe statusi special për shqiptarët në Mal të Zi. Përmes këtij Këshilli, Rugova për pak kohë mori udhëheqjen politike mbi të gjithë shqiptarët informues Jugosllavinë. Sidoqoftë kjo strategji varej nëse Jugosllavia do të mbijetonte si shtet apo do të ndahej në muajt vijues. Prishja e fundit e vendit në 1991-92 i detyroi shqiptarët të ndryshonin strategjinë. Në vend që të vepronin si një organ i vetëm në një shtet, çdo njësi shqiptare brenda ish-Jugosllavisë tani duhej të ndiqte axhendën e vet. Për të krijuar bazën politike për pavarësi, LDK organizoi një referendum për pavarësinë në Kosovë në shtator 1991, në të cilin morën pjesë më shumë se 80 përqind e votuesve të ligjshëm të Kosovës, nga të cilët 99.9 përqind votuan pro (*Bytyqi 2010: fq. 22-39*).

Serbët e Kosovës bojkotuan votimin, i cili u mbajt në fshehtësi, me aktivistët politikë që shkuan të shpërndanin fletët e votimit, derë më derë. Në të njëjtin vit, Këshilli Konsultativ i Partive Politike në Kosovë pranoi propozimin e Rugovës për të krijuar një Qeveri të Kosovës në mërgim nën Bujar Bukoshi si Kryeministër. Këto zgjedhje përfaqësuan një epokë të re në lëvizjen Shqiptare të Kosovës për varësi prej 1, pasi organet e vjetra konsultative u zëvendësuan me të ashtuquajturat institucione paralele, që vepronin në emër të Republikës së Kosovës. Rugova fitoi ligjshmërinë popullore dhe filloi të veprojë si president i zgjedhur. Ndërsa mbështetja kryesore për këtë sistem 1 ishte LDK, partitë e tjera - gjithashtu evoluan. Në këtë mënyrë, skena politike e shqiptarëve të Kosovës filloi të formësohej, me ata që mbështesnin Rugovën dhe ata që e kundërshtuan atë. Për

të shmangur përçarjen e madhe brenda kampit kosovar, Rugova përfshiu ish-të burgosur politikë në udhëheqjen e LDK-së në kongresin e partisë 1994.

Ky fraksion bashkëjetoi brenda LDK-së deri në vitin 1998, kur u ndanë për të formuar një parti të re nën Rexhep Qosja, kritiku kryesor i politikave të Rugovës në vitet nëntëdhjetë. Shpresat që Kosova mund të fitojë pavarësinë përmes mjeteve paqësore u zbehën në 1995 me miratimin e marrëveshjeve të paqes të Dejtonit, të cilat dështuan të adresonin Kosovën në kontekstin e krizës në ish-Jugosllavi. Megjithëse Rugova vazhdoi të gëzonte mbështetjen e shumicës dërrmuese të kosovarëve, kundërshtarët e rinj të rezistencës pacifiste filluan organizimin e një force kryengritëse, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, UÇK, kryesisht në Luginën e Drenicës në Kosovën qendrore dhe rajonin e Dukagjinit të Kosovës perëndimore. Duke vepruar në fshehtësi absolute, UÇK-ja njihej vetëm nga ata që merreshin drejtpërdrejt me të. Shumica e kosovarëve nuk besuan as në ekzistencën e tij deri më 28 nëntor 1997, kur, gjatë varrosjes së një mësuesi të vrarë nga policia serbe në fshatin Llausha, Kosova qendrore, tre udhëheqës të UÇK-së shpallën publikisht platformën e UÇK-së për një kryengritje të aramtosur. Rugova qëndroi publikisht në anën e rezistencës paqësore ndaj sundimit serb gjatë gjithë luftës që pasoi në vitet 1998-99 (*Hamiti 2013*). Në një zgjedhje të organizuar në Mars 1998, ai u rizgjodh President i Kosovës. Gjatë luftës ajrore të NATO-s kundër Serbisë, ai ndau fatin e shumicës së kosovarëve dhe qëndroi në shtëpinë e tij në Prishtinë, megjithëse shumë mbështetës të tij u bashkuan me UÇK-në, ndërsa vazhdonin të besonin në udhëheqjen e tij. Në arrest shtëpie, dhe me kërcënime të vazhdueshme ndaj familjes së tij, siç shpjegoi ai në dëshminë e tij kundër Millosheviçit në Hagë në 2002, Rugova u detyrua të paraqitej para kamerave televizive përkrah armikut të tij më të madh. Shumë e panë këtë si dëshmi të dobësisë së Rugovës dhe menduan se kjo do t'i jepte fund karrierës së tij politike. Sidoqoftë, shumica e kosovarëve e konsideruan vendimin e Rugovës për të qëndruar në Kosovë gjatë bombardimeve si një shenjë e kundërshtimit të tij paqësor të sundimit serb dhe ata e panë paraqitjen në TV si një incident që ai nuk e dëshironte. Kjo gjendje shpirtërore u provua në zgjedhjet e para publike të lira në Kosovë kur LDK fitoi më shumë vota se çdo parti tjetër. Sidoqoftë, që nga ajo kohë deri në zgjedhjet e para komunale në vitin 2000, të cilat LDK i fitoi me 64 përqind të votave, pozicioni politik i Rugova në Kosovë ishte mjaft i dobët. Megjithëse kritikantët ndaj udhëheqjes së tij nuk pushuan kurrë, handikapi i kundërshtarëve të tij ishte ai nën udhëheqjen e Rugovës, në zgjedhjet e para të lira të mbajtura në Kosovë, menjëherë pasi mbaroi lufta me Serbinë, në vitin 2000, LDK-ja habiti shumë njerëz kur fitoi kontrollin mbi shumicën dërrmuese të komunave.

Karriera politike kishte qenë po kaq e pabesueshme. E shpalli Kosovën Republikë, ndërtoi një qeveri dhe institucione paralele, një shtet të tërë paralel dhe zhvilloi zgjedhje që e nxorrën President.

Udhëheqja politike dhe shoqërore ishte zhvendosur në radhët e ish-udhëheqësve të UÇK-së. LDK u votua vazhdimisht si partia më e popullarizuar në Kosovë në katër zgjedhje të njëpasnjëshme, në 2000, 2001, 2002 dhe 2004. Përkundër ndarjeve të brendshme nga të cilat dolën dy parti të reja, Rugova mbeti i pakontestueshëm si udhëheqës i përgjithshëm i Kosovës. Grupet e ndara të LDK-së kurrë nuk fituan mbështetjen e mjaftueshme për t'u përfaqësuar në asamblenë e Kosovës. Njoftimi i sëmundjes së tij në shtator 2005 zbuloi se sa e rëndësishme ishte Rugova akoma në sytë e mbështetësve dhe rivalëve. Ideja që Kosova mund të hyjë në bisedimet e statusit përfundimtar pa të ishte e padëshirueshme për të gjitha palët. Rugova ishte, në fakt, figura e vetme në Kosovë me fuqinë për të bashkuar të gjitha fraksionet.

Për shumë vite me rradhë i bindi kosovarët se prosperiteti i tyre politik dhe historik do të vinte me atë mënyrë siç nuk kishte ardhur kurrë, me rezistencën paqësore, me një lloj gandizmi që nga këto anë të globit nuk ishte njohur kurrë. Ai ishte jo vetëm një udhëheqës por një simbol i asaj që të gjithë donin të bëhej Kosova. Vdekja e tij paraqet një provë të madhe për partitë politike të Kosovës që tani nuk kanë zgjidhje tjetër përveç se të mbështeten në trashëgiminë e tij për të përmbushur ëndrrën e tij. Në ndërkohë, partia e tij, LDK, do të duhet të rimendojë vetveten në muajt e ardhshëm. Partia që mbështeti luftën për pavarësi nën udhëheqjen e Rugovës do të duhet të gjejë një axhendë të re që i përshtatet epokës së re në të cilën po hyn Kosova.

2.2.1. Humanist i bindur me një anë profetike

Rugova nuk mori pjesë në konfrontime ushtarake, duke këmbëngulur që në vend të kësaj të ndiqte një fushatë thjesht politike dhe paqësore për pavarësi. Në fund të viteve 1980, si kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, ai kishte ngritur zërin për të drejtat e shqiptarëve në Kosovë, të cilët kishin gëzuar autonominë si një krahinë brenda federatës komuniste jugosllave, të cilën lideri i ri i Serbisë, Slobodan Millosheviç ishte i vendosur ta shpërbënte. Një ish-gazetar kosovar që në atë kohë ishte një aktivist i ri, Halil Matoshi, tha se Rugova filloi të mbronte të drejtat e shqiptarëve të Kosovës në një kohë kur retorika nacionaliste po shtuhej në të gjithë Jugosllavinë.

“Rugova ishte një intelektual i shquar dhe mbi të gjitha një humanist”, tha Matoshi për BIRN. “Idetë e tij të shkëlqyera mund t’i shikoni në librat e tij. Ai e mbrojti me forcë çështjen e Kosovës në një takim shkrimtarësh në Novi Sad në vitin 1985 dhe në një diskutim midis shkrimtarëve serbë dhe shqiptarë në Beograd në nëntor 1988”, kujton ai. “Rugova hyri në mënyrë të natyrshme dhe fuqishëm në një rrjedhë politike si një vizionar që ndjeu trajektoren e politikës globale në fund të viteve 1980, duke pritur në heshtje momentin e Kosovës”, shtoi Matoshi.

Gjatë punës së tij si gazetar në vitet 1990, ai kujtoi intervistat e shumta në të cilat Rugova i kishte bërë thirrje komunitetit ndërkombëtar që të ndërhynte dhe të ndihmonte në gjetjen e një zgjidhjeje për çështjen e Kosovës. Matoshi tha se ai ishte gjithashtu profetik. “Në vitin 1993, ndërsa shtypja shtetërore nga Jugosllavia, e mbizotëruar nga Serbia, arriti kulmin, në një intervistë ai deklaroi se, “NATO-ja do të na mbrojë” e cila ndodhi më pas në vitin 1999”, vuri në dukje Matoshi, duke iu referuar fushatës ajrore 78-ditore të NATO-s që përfundoi në qershor të atij viti me tërheqjen e Serbisë nga Kosova. Rugova mbeti një humanist në bindjet e tij. Si rezultat, tha ai, ai luftoi jo për “vazhdimin e projektit më të madh të nacionalizmit shqiptar që nga viti 1913, por gjithashtu për një shtet liberal dhe të begatë në paqe me fqinjët e tij”.

Refreni i tij i vazhdueshëm në media ishte që, si një shtet i pavarur dhe sovran, një Kosovë e lirë do të ishte “e hapur drejt Shqipërisë dhe Serbisë”. Matoshi tha se Republika moderne e Kosovës i detyrohet Rugovës për parimet e saj themelore, të ndërtuara në tre shtylla kryesore. “E para është sekularizmi dhe një drejtim pro-perëndimor, e dyta është pavarësia, e ndërtuar mbi parimet e sovranitetit të popullit, dhe e treta është një demokraci e qartë liberale”.

2.2.2. Ndalimi, largimi dhe rikthimi në triumf

Periudha më e vështirë për Rugovën do të vinte më pas. Kur NATO-ja filloi sulmet ajrore në përpjekje për ta detyruar Millosheviçin të tërhiqte forcat policore, ushtarake dhe parashtarake serbe nga Kosova, në mars të vitit 1999, policia mësyu në shtëpinë e Rugovës, duke e vendosur atë dhe familjen e tij në arrest shtëpie në lagjen Velania të Prishtinës. Tre ditë më vonë, duke zemëruar shumë liderët e UÇK-së, ai u detyrua të shkonte në Beograd për të takuar Millosheviçin dhe të shfaqej në televizionin e kontrolluar nga shteti, duke shtrënguar duart me të, në një kohë kur Kosova ishte gjysmë e zbrazur nga njerëzit e saj, të cilët ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre dhe

ishin strehuar në Shqipëri dhe në Maqedoninë e Veriut të ditëve të sotme. Pas më shumë se një muaj nën kontrollin e policisë serbe, Rugova dhe familja e tij u lejuan të shkonin në Itali në maj 1999. Kthimi i tij në Kosovë pas përfundimit të luftës, më 21 korrik 1999, u përshëndet nga mijëra mbështetës të tij në Prishtinë.

Në maj 2002, Rugova u përball përsëri me Millosheviçin, tani në një tjetër kapacitet. Dy muaj më herët, ai ishte zgjedhur si presidenti i parë i Kosovës pas zgjedhjeve të para parlamentare. Millosheviçi ndërkohë ishte arrestuar në vitin 2001 dhe ishte dërguar në Hagë për t'u përballur me akuzat për krime lufte të ngritura nga prokurorë ndërkombëtarë. *“Nuk ishte diçka që unë e doja, por i akuzuari e kërkoi këtë gjë dhe kjo ishte ajo që m'u tha. Po të mos kisha shkuar, do të kishte pasur pasoja”*, tha Rugova në gjykatë. Një ditë pas vdekjes së tij, gazeta Kosova Sot në Prishtinë e risolli në kujtesë Rugovën si *“Gandin e Kosovës”* (Keka 2011: fq. 10-17).

2.3. Bota dhe Dr. Ibrahim Rugova dhe trinomi: Liri, Pavarësi dhe Demokraci

Trinomi: Liri, Pavarësi dhe Demokraci pa dyshim ishte filozofia dhe përcaktimi i tij politik dhe jetësor. Këtë e kanë cekur edhe autorët dhe studiuesit tanë dhe të huaj, politikën e tij kombëtare dhe ndërkombëtare kështu: *“Madje vizioni i Ibrahim Rugovës nuk ishte shfaqur ndonjëherë në historinë e të gjitha vendeve ballkanike. Ai ishte një lloj lëvizjeje, që synonte detyrimin moral, bazuar në vlera. Ajo ishte një lëvizje për çlirimin bazuar në virtyte, në moralin e shoqërisë njerëzore. Thelbi i lëvizjes së Rugovës për çlirim ishte mospërdorimi i dhunës... Para së gjithash kjo strategji kërkonte vetëdije të plotë politike, vetëbesim, si dhe përgatitje psikologjike, shpirtërore, sociale e shoqërore të njerëzve që e përfaqësonin... Dy milion shqiptarë ishin bashkuar në mbështetjen e tyre ndaj politikave të lëvizjes çlirimtare, të cilat i kishte prezantuar Rugova”* .

Vizioni i tij ishte mjaft i qartë, shumë i vendosur dhe për këtë së shpejti ishte shndërruar në Lider, udhërrëfyes dhe vizionar në nivelin popullor, të intelektualit, të rinia, me paraqitje të dinjiteteshme dhe të qeta, njëkohësisht të vendosura dhe parimore, por edhe të argumentuara dhe paqësore. Natyra e tij e butë, niveli i tij intelektual i lartë, largpamësi e tij pothuaj profetike e ndihmonin dukshëm në këto veprime. Për këtë ishte dhe do të jetë përfaqësuesi ynë i denjë në luftë për liri dhe demokraci në skenën kombëtare dhe ndërkombëtare gjatë viteve 1989-1999 si dhe pas Luftës, deri në vdekje Strategjia kombëtare e filozofisë së Rugovës ishte: “Kosova e integruar në Bashkimin Evropian dhe në miqësi të përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës”. Çdo shmangie nga kjo strategji është fatkeqësi kombëtare, ndryshim i boshtit që e vë në dyshim pavarësinë dhe e vë në rrezik qenien tonë kombëtare.

2.3.1. Liri (1989-1999)

Kjo dekadë e historisë moderne të Kosovës tanimë ka shënuar periudhën kohore më të vrazhdë dhe më të përgjakëshme për vendin tonë. Përpjekjet për liri të Kosovës ishin maratonike dhe mbi të gjitha sistematike. Nën udhëheqjen e Dr. Rugovës, rezistenca aktive paqësore e shqiptarëve të Kosovës për liri u bë shembulli më i çmuar në botë për angazhimin sistematik të një populli për liri *vis-a-vie* një xhelati pushtues. Organizimi dhe funksionimi i shtetit paralel të Kosovës në këtë kohë u bë një nga veçoritë unike të veprimit politik rugovian.

Kulmimi i përpjekeve për liri në këtë kohë erdhi me daljen në skenë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si goditja ultimative, që do i jepej pushtuesit serb. Lufta për çlirim e djemëve dhe vashave më të mira të vendit i dha vulën e fitores përpjekjes së Kosovës për liri. Toka e Kosovës tanimë u bë altar i lirisë për shumë heronjë e heroina, si dhe u ujit me gjakun e mijëra civilëve, të moshuarëve e fëmijëve shqiptarë që u bënë viktima të gjenocidit serb. Përpjekjet e rezistencës aktive paqësore për gati dhjetë vite para luftës frontale në Kosovë, veçse kishin alarmuar faktorin ndërkombëtar për kërkesat e drejta dhe legjitime të popullit të Kosovës si dhe për planet serbe. Konferenca e Rambujesë e kishte bërë faktorin ndërkombëtar të kuptojë se Serbia pos dhunës nuk kupton gjuhë tjetër. Lufta për çlirim ishte thirrja e fundit për shpëtim të një populli për të jetuar i lirë dhe në paqe në tokat e veta autoktone. Perëndimi nën udhëheqjen e SHBA-ve nuk mundi të rrijë duarkryq, por iu vursul Serbisë me NATO-në nga qielli deri në çlirimin përfundimtar të Kosovës.

2.3.2. Demokraci (1999-2008)

Pas çlirimit të Kosovës, pas vendosjes së NATO-s për të ruajtur paqen dhe sigurinë në vend, institucionet qeveritare të vendit u krijuan nga Misioni i Përkohshëm për Administrimin e Kosovës nga Kombet e Bashkuara (UNMIK). Nën tutelën e UNMIK-ut, Kosova kaloi një periudhë kohore gati se dhjetë vjeçare gjatë së cilës ajo ndërtoi institucionet veta vetëqeverisëse si në nivel lokal ashtu edhe në atë nacional. Kjo periudhë shënon kohën gjatë së cilës Kosova e përvetësoi mjaftueshëm demokracinë. E them këtë, sepse elementet kyçe të demokracisë filluan të zbatohen plotësisht dhe sipas standardeve ndërkombëtare në Kosovë zgjedhjet e lira dhe fer, themelimi dhe funksionimi i institucioneve të sundimit të ligjit, liria e fjalës, transferi i pushtetit nga një parti tek tjetra, ekonomia e tregut të lirë, etj. Demokracia ishte praktikuar në Kosovë edhe para 1999-tës, por pa legjitimitet ndërkombëtar.

Tanimë, edhe pse nën tutelën e UNMIK-ut, kjo periudhë kohore i shërbeu Kosovës për të mësuar sjelljen institucionale dhe shtetërore të një demokracie liberale. Rol esencial në këtë periudhë të demokracisë institucionale përsëri kishte luajtur Dr. Rugova dhe LDK-ja. Përkundër faktit që në zgjedhjet e para nacionale të pasluftës Dr. Rugova kishte fituar një shumicë solide të vendeve në parlament, për hir të konsolidimit shtetëror e institucional, ai kishte pranuar kompromisin e madh që qeverinë e vendit asokohe ta udhëhiqte Dr. Bajram Rexhepi nga kampi oponent i LDK-së, nga PDK-ja. Njëtrajtshëm kishte vepruar Dr. Rugova përsëri kur pozitën e të parit të qeverisë ia kishte dhënë Ramush Haradinajt nga AAK-ja. Rugovizmi si filozofi politike ishte ndërtuar mbi kompromisin për shtetin dhe jo për pushtetin. Veprimet politike të LDK-së në atë kohë ishin testamenti më i mirë i rugovizmit real.

2.3.3. Pavarësia (2008-2019)

Pas gati dhjetë vite praktike demokratike nën tutelën e UNMIK-ut, Kosova tanimë ishte e gatshme që vet dhe si e pavarur ta vazhdojë rrugëtimin e shtetndërtimit. Rrjedhimisht pas një periudhe disavjeçare të negocimit për statusin final politik të Kosovës nën udhëheqjen dhe ndërmjetësimin e të deleguarit të posaçëm të OKB-së, z. Marti Ahtisaari, Kosova në koordinim me miqtë e vet perëndimor, shpalli pavarësinë e vendit me 17 shkurt 2008. Procesi i negociatave të Vjenës nuk ishte as i lehtë e as i shpejtë. Suksesin që Kosova arriti ta nxjerrë nga ky proces shpalljen e

pavarësisë së vendit nuk është se nuk e pagoi koga me kompromise të mëdha për minoritetin serb në Kosovë.

Dr. Rugova si udhëheqës i Ekipit të Unitetit, ku rol kyç kishte edhe opozita e vendit, asokohe e udhëhequr nga Hashim Thaçi, kishte bërë atë që më nuk mundi ta bëjë askush. Ai kishte arritur që për interes shtetëror të fuzionojë pushtetin bashkë me opozitën. Dr. Rugova fatkeqësisht nuk jetoi për të parë shpalljen e pavarësisë së Kosovës, po ai ishte hallka pa të cilën, realisht pavarësia vështirë se do arrihej. Faza e paspavarësisë në procesin e shtetndërtimit të vendit ka pasë më shumë turbulencë sesa progres solid. Tani e mbi një dekadë pas shpalljes së pavarësisë, procesi i dialogut Prishtinë-Beograd ka tejkaluar çdo kufi të një dialogu Teknik siç ishte filluar, dhe ka rrëshqitur krejtësisht në një proces të rinegociimit të statusit të Kosovës. Sot flitet për ndryshim kufijsh, shkëmbim territoresh, për gjykatë speciale e për çnjohje të pavarësisë nga vende që veçse e kishin njohur shtetësinë e vendit njëherë. Katrahura politike në të cilën vendi ynë ka hyrë pas mëse një dekade shtetndërtimi në pavarësi është jo vetëm se brengosëse por edhe sfiduese për vazhdimin e procesit të shtetndërtimit.

Në secilën prej këtyre fazave, veprimet politike të Dr. Rugovës sa ishte gjallë, ishin rugovizmi në praktikë që shënuan secilën prej këtyre dekadave: rezistenca paqësore aktive në fund të së cilës Dr. Rugova vënë në ballë ata që thirreshin në udhëheqjen politike të UÇK-së, duke i lënë të njëjtëve kryesimin e delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambujesë, duke vënë interesin shtetëror e popullor mbi atë pushtetar (dekada e përpjekjeve për liri, 1989-1999); demokratizimi institucional në Kosovës sipas standardeve ndërkombëtare dhe i njohur ndërkombëtarisht përmes zgjedhjeve të lira dhe fer, transferit të pushtetit, sundimit të ligjit, lirisë së shprehjes, ekonomisë së tregut të lirë, nën tutelën e UNMIK-ut, duke pranuar kryeministra konsensusi për të ruajtur balancin politik dhe petkun multipartiak të marrjes së përgjegjësisive institucionale (përsëri duke vënë në rend të parë interesin shtetëror dhe jo atë pushtetar a partiak); si dhe pavarësimi i vendit, edhe pse ky proces kulmoi pas vdekjes së Dr. Rugovës, veprimet e tij politike para se te shkonte në amshim kishin vënë gurthemelin e duhur në Ekipin e Unitetit, fryma e të cilit përcolli qeverisjen e vendit gati edhe një dekadë pas shpalljes së pavarësisë së vendit (prap duke lënë anash privilegjin e pushtetit personal, por duke vënë në rend të parë rëndësinë e interesit shtetëror të vendit).

2.4. Dr. Ibrahim Rugova dhe ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës dhe më gjerë, asaj shqiptare në Ballkan

Ai sigurisht se ishte Lideri ynë që paraqiti kërkesat popullore dhe të drejtën themelore për liri, demokraci dhe vetëvendosje, pas gjithë asaj që kishim pësuar historikisht dhe aktualisht. Bindja e tij e thellë dhe jetësore se shqiptarët jemi në anën e të mirës, të drejtës dhe të vërtetës, pra, kemi argumente si historike, ashtu edhe aktuale, apo si e kisha formuluar unë: ne shqiptarët thënë figurativisht kemi mall të mirë, por jemi tregtarë të dobët, që Ibrahim Rugovës i pëlqente shumë, e shtynte atë për internacionalizimin dhe sensibilizimin e çështjes së Kosovës, sepse e dinte fare mirë se bota do të jetë me ne, jo pse jemi shqiptarë, apo kundër serbëve, por për hir të së drejtës dhe të vërtetës, kuptohet, nëse dimë ta paraqesim dhe mbrojmë botërisht.

Këtyre tri të vërtetave duhej t'i shtoheshin edhe dy shtylla të rëndësishme: vetëdija jonë kombëtare dhe përcaktimi ynë paqësor dhe jodhunor deri në fund, pa hequr kurrë dorë prej vetvetes dhe të vërtetës, lashtësisë, traditës, kulturës dhe qytetërimit tonë të lashtë iliro-shqiptar. Kjo “luftë”

mediale pamoro-dëgjimore e mjeteve të komunikimit, e qarqeve politike dhe diplomatike, dukej si ajo biblike mes Davidit dhe Goliatit, sepse serbët kishin çdo gjë në dorë. Mirëpo Presidenti Ibrahim Rugova shpesh thoshte kështu: “Ne anën tonë është e vërteta, historia, toka e Kosovës” (*ASSEMBLY SUPPORT INITIATIVE 2006*).

Pa këtë fitore mediale dhe politike kurrë nuk do të vinte deri te ndërhyrja e NATOS, Lufta Çlirimtare e Kosovës, pra, deri te liria dhe pavarësisë së Kosovës. Konfliktet luftarake dhe jostabiliteti i vazhdueshëm u bënë argumente shtesë për supozimin se rajoni i Ballkanit Perëndimor parimisht ndryshonte nga trendi i përgjithshëm ndër rajonal. Mirëpo, në kuadër të proceseve të integritetit dhe të globalizimit, rajoni i Ballkanit Perëndimor i afrohet gjithnjë e më shumë Evropës. Ku përshkruan, duke u nisur nga tensionet midis proceseve të integritetit (në BE) dhe fenomeneve të nacionalizmit dhe të patriotizmit në epokën e globalizimit. Këto tensione në hapësirën e Ballkanit Perëndimor çojnë te një ndryshim i perceptimit të identitetit vetjak kombëtar dhe kulturor. Ato kanë edhe pasojat politike, të cilat njëkohësisht paraqesin shans dhe sfida, si për rajonin e Ballkanit Perëndimor ashtu edhe për BE-në: bëhet fjalë për potencialin që në të ardhmen të zvogëlohen dallimet socio-politike midis rajoneve (*Bytyqi 2010: fq. 41-52*).

2.4.1. Filozofia politike dhe nacionale e Ibrahim Rugovës

Në historikun e ngjarjeve që lidhen me të kaluarën dhe të tanishmen shqiptare vend të veçantë padyshim zë edhe periudha pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 1963, periudhë kjo e njohur me subjektivitetin e zbehur të Kosovës të përcaktuar me Kushtetutë dhe aktet tjera normative, për të cilat shqiptarët nuk e përceptuan dhe e injoruan skajshmërisht deri në vitin 1968 me ndryshimet kushtetuese, njohjës së simbolit kombëtar, përshtatshmëria e të drejtës zakonore me të drejtën juridike si dhe seleksionime tjera në fusha të ndryshme, por që në realitet nuk përputheshin me të drejtën aktuale juridike me njësitë tjera në ish-federatën jugosllave, gjë që shqiptarët ndiheshin jo të sigurtë në proceset zhvillimore nga më të ndryshmet e deri te realizimi i së drejtës së paku për vetëvendosje.

Vetë mbetja e Kosovës nën bazat e regjimit unik të Serbisë mbi tërë territorin e Kosovës dhe përdorimi i simboleve serbe në jurisprudencë dhe administratë, të parapara këto sipas nenit 300 dhe 301 të Kushtetutës serbo- jugosllave të vitit 1974, dhe se përfaqësimi i Kosovës nga pozita e statusit autonom në organet shtetërore ishin vazhdimësi e tërthortë e ç’kombëtarizimit dhe varësisë

së plotë politike, ekonomike, juridike e sociale të shqiptarëve, ishin edhe bazat e para destruktive, që i shtynë shqiptarët për të menduar ndryshe drejt realizimit dhe krijimit të subjektivitetit shtetëror, që ishte i paraparë edhe me aktin më të lartë juridik të ish-Jugosllavisë (*Bytyqi 2010: fq. 41-52*).

Kështu, që detyrimisht lindi nevoja, që shqiptarët të organizohen siç ishin organizuar edhe njësitë tjera përbërëse, për më tepër kjo, sepse shqiptarët ishin populli më i diskriminuar dhe më i papërfillur nga regjimi sllave, që kategorizoheshin në nivel të statutit politik të bashkësisë lokale. Pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 1963, përbërja nacionaliste shqiptare, (shumica e të cilëve përvijoheshin dhe burgoseshin nga sistemi totalitar hegjemonist serb) edhe pse në kushte të vështira, vepruan qoftë edhe ilegalisht në shërbim të Kosovës, për të vazhduar kështu deri në vitin 1989, kur në krye të tyre erdhi lideri shqiptar Dr.Ibrahim Rugova.

Pra, Rugovizmi, si linjë politike e kombëtare, për më tepër si lëvizje antikomuniste u paraqit fillimisht para vitit '68 për të vazhduar dhe implementuar një linjë të tillë nacionaliste edhe në ditët e sotme, kur Kosova dhe shqiptarët akoma vazhdojnë të pengohen nga servilë të fabrikuar në uzinat greko-serbe. Përgjatë ndryshimeve të mëdha politike në ish-Jugosllavi, në kohën kur statusi politik i Kosovës u suprimua (1989) edhe me ato pak të drejta politike e juridike, që i'u patën garantuar me Kushtetutën e vitit 1974, njerëz të linjës nacionaliste skajshmërisht justifikuan veprimet e tyre procesive në formimin e shtetësisë së Kosovës. Kjo, për arsye që Kosova të ketë subjektivitet ndërkombëtar, dhe njëherë e përgjithmonë të lirohet nga tutela pansllave (*Nurboja 2018: fq. 41-67*).

Dihet se figurat e njëjta kombëtare, që udhëhiqeshin nga e drejta historike kombëtare e shqiptarëve në Kosovë, dhe udhëheqnin popullin kah e drejta e tyre konform me të drejtat e kombeve tjera, që përfaqsoheshin në ish-federatën jugosllave, bënë që ideja dhe qëllimi për realizimin e të drejtës kushtetuese që lidhet me të drejtën e vetëvendosjes dhe shkëputjes, të mos hezitojnë të vihen në shërbim të mëvetësisë dhe sovranitetit shtetëror në kuadër të integritetit territorial të Kosovës që e gëzonte edhe para luftës së dytë botërore, apo edhe para Lidhjes së Prizrenit (1879).

Nuk ishte e rastit që njerëzit e dëshmuar kombëtarisht dhe shkencërisht sic ishte akademik Fehmi Agani, akademik Gazmend Zajmi, Rrezak Shala (këta tashmë të ndjerë) dhe akademik Mark Krasniqi, të gjenden si avangardistë të udhëheqjes kombëtare për shtetësinë e Kosovës, si vazhdimësi e të cilëve organizohet edhe dr.Ibrahim Rugova me shumë personalitete tjera të kulturës dhe shkencës, i cili dhe të cilët për emërues të përbashkët kishin dhe kanë realizimin e

kërkesës më subline dhe më madhore pavarësinë e Republikës së Kosovës me mjete politike në pamundësi tjetër, ngase Kosova nuk kishte akoma aleatë të përkrahjes ushtarake edhe pse nuk mungonte edhe zgjidhja me mjete tjera, siç u dëshmuua edhe në luftën shqiptaro-serbe (*Nurboja 2018: fq. 41-46*).

Vetë formimi i lëvizjes kombëtare shqiptare, që në fillim emërohej si Alternativa Shqiptare, e që kishte për qëllim zbrapsjen e shqiptarëve nga nomenklatura komuniste, dhe pastaj shkrirja e kësaj lëvizjeje në Lidhjen Demokratike të Kosovës, ishin simptomat e para të një vdekjeje biologjike të krijesës sllave dhe prosllave në Kosovë dhe më gjerë. Përfaqësi i saj kryesor, siq është e njohur, dr.Ibrahim Rugova, figurë qendrore dhe më me ndikim në proceset e demokratizimit dhe shtetëzimit të shtetit të Kosovës, internacionalizimit dhe senzibilizimit të saj në arenën ndërkombëtare, të cilat do ta shpiejnë Kosovën drejt njohjes përfundimtare të subjektivitetit të saj shtetëror si dhe me ndikim pozitiv edhe në rrjedhat politike e kulturore në Shqipëri dhe trojet tjera etnike, bëri që nyja shqiptare në Kosovë të kuptohet katërçipërisht si e drejtë e patjetërsueshme juridike konform me të drejtën ndërkombëtare publike dhe aktet tjera të nivelit ndërkombëtar. Si kryetar i Lidhjes Demokratike dhe i shtetit të Kosovës, pastaj si lider i krijuar në momentin historik dhe kombëtar, dr. Rugova u vu në krye të një lëvizjeje popullore dhe në shërbim të realizimit të së drejtës kombëtare, jo për t'u privilegjuar si i paprekshëm dhe për të bërë emër siç tentojnë të bëjnë të tjerët në të arriturat e tij, por për të bërë zgjidhjen e çështjes nacionale, për të krijuar para faktorit ndërkombëtar imazh pozitiv dhe progresiv se shqiptarët janë popull që kanë kulturë udhëheqjeje dhe që kultivojnë me ndershmëri proceset demokratike e njerëzore, me një profilizim dhe profesionalizëm të ngjajshëm me proceset e shteteve në zhvillim të botës perëndimore dhe asaj amerikane (*Nurboja 2018: fq. 42-46*).

Dr.Rugova përcaktoi me sukses kornizat e politikës institucionale për internacionalizimin e çështjes së Kosovës siç ishin: Referendumi, shpallja e Kushtetutës, zgjedhjet presidenciale dhe përfaqësuese, krijimi i ministrisë së Mbrojtjes, kërkesa për implementimin e protektoratit ndërkombëtar në Kosovë dhe vendosshmëria e vazhdueshme dhe kontinueive para qendrave të vendosjes për njohjen e pavarësisë së Kosovës. Çështje këto, të cilat kërkuan mund dhe sakrifica kur merret parasysh prania e Serbisë fashizoide dhe statusi kolonizues i Kosovës, i cili de facto dhe de jure nuk njihej si e tillë nga faktori ndërkombëtar. Madje, kërkesat e shqiptarëve nuk përfilleshin as për afërsisht sidomos nga evropianët, derisa në zgjidhjen e çështjes së Kosovës u

inkorporua politika amerikane me të zgjedhurin e saj dr.Ibrahim Rugovën, gjë që u pa me ndërhyrjen e NATO-s dhe bombardimet e saja mbi caqet ushtarake serbe jo vetëm në Kosovë. Sidoqoftë, shqiptarët përjashtuar këtu ata të linjës Kretë-Beograd-Tiranë, tashmë janë formuar politikisht dhe dijnë t'i çmojnë vlerat dhe të arriturat e mirëfillta kombëtare, veçmas filozofinë politike të dr.Rugovës për sovranitetin shtetëror të Kosovës, shqiptarizmin e tij të pastër prijës dhe organizativ, dhe të arriturat e çdo individi veç e veç, pa e përbuzur dhe abuzuar edhe punën më të vogël në të mirë të çështjes së Kosovës. Studimi i mirëfilltë i hulumtuesit tashmë të njohur dhe të afirmuar ndër ne dhe më gjerë Enver Bytyçi "Filozofia politike dhe nacionale e Ibrahim Rugovës"- ka mjaft dhe përparësi, sepse e trajton figurën e Presidentit historik të Kosovës, Dr. Ibrahim RUGOVA nga disa shqyrtime dhe këndvështrime të ndryshme dhe në kontekstin e ngjarjeve shqiptare, pastaj jugosllave, ballkanike, deri diku edhe evropiane dhe botërore (*Bytyqi 2010: fq. 81-83*).

Në pranverën e vitit 2001 Ibrahim Rugova kishte vizituar Berlinin. Atë botë në Maqedoni bëhej luftë dhe në takimin me kancelarin gjerman, Gerhard Schröder, ky i fundit i kishte kërkuar liderit legjendar i Kosovës që ti dënonte luftëtarët e UÇK-së në Maqedoni. Europa ishte e zemëruar me shqiptarët, madje në shumë kryeqytete vlerësonin se "Ishte bërë gabim që NATO kishte intervenuar për çlirimin e shqiptarëve të Kosovës nga sundimi e dhuna serbe". Ajo e quante vendimin për çlirimin e Kosovës si një "dhuratë" për shqiptarët dhe konsideronte se lëvizjet e dhunëshme të shqiptarëve në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc më 2000-tën e ajo e shqiptarëve të Maqedonisë në pranverën e vitit 2001 ishin "thikë prapa shpinës së saj".

Megjithë përpjekjet maksimale të presidentit të Kosovës për ta futur çështjen e Kosovës në margjinat dhe vendimmarrjen e Bashkësisë Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, kishte injoruar këtë problem. Një letër e Rugovës për lordin Kerrigton, i ngarkuar i OKB-së për ish-Jugosllavinë, në të cilën ai kërkonte të drejtën e barabartë me republikat ish-Jugosllave për pjesëmarrje, debat dhe vendimmarrje për Kosovën, ishte injoruar nga Fuqitë evropiane. Kosova, megjithë këmbënguljen e Rugovës, nuk ishte pranuar në Konferencën për ish-Jugosllavinë, të mbajtur më 1991 në Londër. Europeanët vazhdoni ta shihnin çështjen e Kosovës si "çështje të brendshme të Serbisë" dhe kërkonin nga Serbia thjesht "respektimin e të drejtave të njeriut". Sesi mund të quheshin "njerëz" dy milion shqiptarë dhe "popull" 200 mijë serbë e pakica të tjera, kjo nuk mund të gjente shpjegimin e vet shkencor (*Nurboja 2018: fq. 52-67*).

Ndërkohë që SHBA-të kishin treguar gatishmërinë e domosdoshme për zgjidhjen e kësaj çështjeje delikate ballkanike e europiane, vetë Europa ishte treguar e ngathët, e pa orientuar qartë dhe e pasuksesshme. SHBA-të së paku kishin koncepte më të qarta. Të gjitha deklaratat dhe dokumentet zyrtare e jozyrtare amerikane flisnin dhe dënonin "shkeljen e të drejtave të njeriut si dhe të të drejtave kombëtare të shqiptarëve në Kosovë", ndërsa konfliktin e cilësonin si konflikt etnik. Kjo do të thoshte se ideja dhe filozofia politike e Ibrahim Rugovës ndërsa gjente shprehjen dhe mbështetjen e vet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nuk respektohej nga partnerët europianë. Konferenca e Dayton-it e vjeshtës së vonë të vitit 1995 e kishte lënë çështjen e Kosovës gjithashtu në një aneks, pa i dhënë zgjidhje dhe pa premtuar një perspektivë të qartë (*Keka 2011: fq. 28-40*). Në këtë Konferencë ishte pjesëmarrës dhe delegacioni shqiptar i kryesuar nga Rugova, por jo me të drejtën e shprehjes për ndonjë opion zgjidhjeje për Kosovën. Amerikanët kishin premtuar se pas Bosnjës do ti vinte radha Kosovës. Por ky premtim kishte qenë konfidencial, jo zyrtar, jo publik. Kjo do të thoshte se SHBA-të atë kohë nuk gjenin konsensusin e përbashkët me europianët për këtë zgjidhje.

Ndërkaq Rugova kishte vazhduar të insistonte në realizimin e opsioneve që kishte paraqitur që para pesë vitesh. Opsionin për pavarësi ai e kishte argumentuar që në vitin 1992, kur në Londër ishte mbajtur Konferenca e parë për ish-Jugosllavinë. Duke protestuar për mungesën e Kosovës në atë Konferencë, Ibrahim Rugova u kishte paraqitur kryesuesve të asaj Konference, Owen dhe Kerrington, një plan prej 10 pikash, i cili do të duhej të merrej në konsideratë për ti dhënë fund krizës në Kosovë. Thelbin e atij dokumenti e përbënte argumenti se "Kosova kishte të njëjtën të drejtë si edhe ish-republikat jugosllave të vendoste vetë për fatin e saj..."(*Bytyqi 2010: fq. 81-83*).

2.5. Kosova si subjekt i ri në politikë

Kontinenti evropian ka një histori të stuhishme. I përbërë nga një numër i madh të shteteve të ndërtuara që moti, i ndarë përgjatë katër dhjetëvjeçarëve nga një perde e hekurt, që simbolizon vetë luftën e ftohtë që erdhi pas konfliktit të dytë botëror, ai paraqiste një pamje që e nuhasnim të përfunduar. Pa i llogaritur ngjarjet që përgjakën ish-Jugosllavinë, si skenë tragjike të spazmave të fundit të perandorisë sovjetike. Filloi një periudhë e re në historinë e Evropës, plotë paqartësi. Lindi një shtet i ri, pa histori shtetërore: Kosova. Ky fat i habitshëm gudulis kureshtjen: si ndërtohet një shtet në fillim të shek. XXI? Ç’rrugë duhet të përdorë, që të mund të emërohet si “Shtet i së drejtës”? Si mundet një shtet të bëhet me administratë, struktura performuese, pa të kaluar shtetërore dhe pasi të jetë përjetuar për gati se një dhjetëvjeçar një lloj “protektorati” të bashkësisë ndërkombëtare (OKB dhe BE)?

Sepse shteti i Kosovës është krijuar pothuajse “ex nihilo” (nga asgjëja). Dikur juridikisht pjesë e Republikës së Serbisë sipas Kushtetutës së vitit 1974, e që kishte të gjitha të drejtat e një republike

para se të shfuqizohet autonomia e saj pesëmbëdhjetë vjet më vonë, e varur pastaj nga diktatet e fuqive “mbrojtëse”, Kosova është dashur të shpiket si një shtet-komb dhe ta mendojë një kuadër normativ efikas, duke ëndërruar një fat brenda bashkësisë ndërkombëtare aspak të njëzëshme mbi nevojën e krijimit të një shteti të ri ballkanik, por edhe mbi ligjshmërinë e tij në aspektin e së drejtës ndërkombëtare: si të njësohen respekti i integritetit territorial në njërën anë dhe e drejta e vetëvendosjes në anën tjetër? Për t’u përpjekur të kuptohet se si Kosova - rajon shqipfolës i plagosur nga një luftë e dhunshme të paraprirë nga shumë vite represioni - është bërë shtet-komb i njohur nga 115 shtete sot, nuk qe e mundur të trajtohen të gjitha aspektet përbërëse të një shteti modern. Jemi fokusuar në disa prej tyre, duke shpresuar që disa analiza të tjera do të shpalosin pjesët e tjera të rrugëtimit që ka shpër në krijimin e Kosovës.

Vlen të rikujtohet konteksti historik në të cilin ka zënë vend ngjarja e krijimit të këtij shteti-komb të ri të shek.XXI. Pa këtë kthesë përmes së kaluarës do të ishte e vështirë të kuptohen veçoritë, duke pasur parasysh që e tërë historia kombëtare është kontribuese e ngjarjeve që prodhohen pak a shumë larg kufijve të tij dhe të frymës së kohës. Kur heshtën gjyket në fund të luftës së dytë botërore, shumë shpejt, kontinenti duket sikur i ngrirë nën kaosin e luftës së ftohtë. Një formë e re shtetërore vendoset nën mbrojtjen e ombrellës bërthamore të Shteteve të Bashkuara. E dalur nga rrënojat e sistemeve pak a shumë demokratike njëherësh të përçmuara, që në përfundim të Luftës së Parë Botërore, pastaj të turpëruar nga totalitarizmat, kjo formë e shtetit synon të pajtoj nën autoritetin e saj parimet e lirisë të zhvilluara në shek.XIX dhe një vokacioni social, themelet e të cilit janë skicuar në vitet 1880. Ballkani duket larg këtij realiteti: megjithatë, ky do të formësojë shpirtërat dhe ndikojë në mënyrë të zhdrejtë fatin e ardhshëm të këtij rajoni.

Fundi i luftës përshpejtoi konkretizimin si shtet të llojit njëkohësisht providencial dhe liberal, teorizuar nga anglezi Beveridge. Ai duhet t’i paqëtojë shoqëritë perëndimore duke i imunizuar kundër të gjitha joshjeve për rrjedhje drejt fashizmit, nacizmit ose komunizmit. Për ta prekur këtë rezultat, në një sjellje antikomuniste që do të shërbente për të përafuar socialistët me bindje socialdemokrate dhe të djathtën “borgjeze”, liberale ose historikisht katolike-konservatore, shteti modern në lindje realizon një sintezë ku njihen së bashku përmes një loje të koncesioneve reciproke, nevoja për një ekonomi të tregut, një mbrojtje të besueshme ushtarake dhe një sistem të sigurisë sociale. Këto duhet të garantojnë një siguri ekonomike minimale për klasat e nëpërkëmbura, për të papunët dhe personat në moshë të shtyer.

I ushqyer nga rritja e jashtëzakonshme ekonomike që e shoqëron, kryesisht, përgjatë tridhjetë viteve të pasluftës, shteti providencial, tani e tutje në drejtim në të gjitha shtetet demokratike, ngazëllehët në një kuadër me sa duket të ruajtur nga çdo lloj aksidenti. Duke ia kushtuar një lloj konsensusi të institucionalizuar midis një të djathtë dhe një të majte që janë kujdesur për të shkëputur të gjitha marrëdhëniet më ekstremet, demokracitë e lindura nga lufta organizohen në idenë e pjesëmarrjes së pushtetit të hapur për të gjitha partitë. Për shembull, më 1959, socialdemokracia gjermane shkëputet nga të gjitha referencat marksiste. veprim ky që do t'ia mundësojë asaj që të ngjitet në mënyrë demokratike në pushtet dhjetë vite më vonë, në një moment të parë përmes një koalicioni me demokristianët shumicë që nga paslufta (*KIPRED 2015*).

Por, të dy “popullizmat” bashkohen në nevojën “kombëtare” të veprimit të tyre, me Bashkimin evropian si shënjestër të ndëshkimit të tyre. Pa dyshim se dy “nacionalizmat” nuk mbivendosen. Ai i së djathtës orientohet qartësisht drejt një përparësie “kombëtare”, krejtësisht konservatore dhe sot në modë sidomos në disa shtete të lindjes. Popullizmi i majtë sheh më shumë në shtetin-komb një digë kundër të këqijave që i kushtohen “neoliberalizmit”, që mendohet se ka toleruar socialdemokracia klasik.

Megjithatë, kombi është rishfaqur në tavolinën e qeverive edhe pse për këto parti, kombi është vetëm petku i këtij populli të mitifikuar duke pretenduar secili në mënyrën e vet të qenit zëdhënësit e tij të vetëm. Pra është në këtë kontekst të çuditshëm, gjenerues i një shoku kulturor, përmasat e të cilit ende nuk i kemi të qarta ende sot, që shtetet ish-komuniste, sot anëtare të Bashkimit Evropian, janë bërë pjesë e radhëve të shteteve demokratike, e sidomos Kosova. Kjo e fundit me një veçori: shtetet e tjera zotëronin një strukturë shtetërore, si shtete zyrtarisht sovranë ose anëtare të federatës. Kosova ishte vetëm krahinë... e cila është dashur të ndërtohet me “kumbarët”, entitetet mbikombëtare dhe shtetet që përballëshin me kërkesa kombëtare legjitime, por të paafta për të parë se si përshtatet me në një botë që supozohej e ç’kombëtarizuar...

Ky rikujtim i kontekstit historik të veçantë, shumë rrallë i theksuar, nuk duhet ta shfajësojë Kosovën nga gabimet e bëra që nga shpallja e njëanshme të pavarësisë së saj. Përkundrazi, në anën tjetër, ai duhet ta mundësojë rivendosjen e krijimit të këtij shtetit-komb të ri në ambientin e një momenti politik të pareduktueshëm nga një lexim shumë linear. Ishte i komplikuar mjedisi gjeopolitik ku e ndërton vendin e tij, edhe pse nuk është vendi këtu për ta komentuar sjelljen

nganjëherë ambivalente të fuqive që e kanë sjellur Kosovën në gërmat e pagëzimit. Por nuk ishte as kuadri filozofik.

Tranzicionet drejt demokracisë të llojit perëndimor mund të jenë vetëm të gjata dhe ato i binden një mori kushtesh. E këto shtete kanë pasur shpesh prirje të kërkojnë rezultate të shpejta, nëpërmjet një zhvendosjeje fillestare të rregullave të tyre në një kontekst shumë të ndryshëm. Nga këto vjen interesimi për t'i shqyrtuar me imtësi proceset që e shoqërojnë ndërtimin e shtetit të Kosovës. Për ta vlerësuar më mirë punën e kryer, për ta dalluar edhe atë që nuk ka funksionuar sa duhet në vendosjen e institucioneve mjaft komplekse. Jo për ta bërë bilancin e çështjeve pozitive dhe negative, siç është thënë në hyrje të këtij teksti. Por për t'i identifikuar problemet që lidhen me ndërtimin e një shteti të ri dhe elementet që duhen ta mbajnë vëmendjen e atyre që shqetësohen me fatin e Kosovës. Kuptimi i tyre përbën një periudhë të domosdoshme për ta përgatitur një të ardhme të qetë për një shtet ende të brishtë (*Nurboja 2018: fq. 136*).

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Sot ka shumë probleme dhe ngërqe politike. Ibrahim Rugova ishte një politikan shumë i suksesshëm në shtetndërtimin e Kosovës i cili përdori një politikë mjaft paqësore për lirimin e Kosovës nga okupimi serb. Duke mbajtur marrëdhënie të mira me fuqitë e mëdha mendoj se politika e tij duhet ndjekur si shembull nga pasuesit e tij dhe të tjerë, dhe kjo është arsyeja që më ka shtyer ta zgjedh këtë temë.

4. METODOLOGJIA

Në këtë punim do të aplikohen metoda të ndryshme, për shqyrtuar sa më mirë rolin e shpalljes së pavarsisë së Kosovës në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit rajonal dhe ndikimit, që ka pasur ky akt në rajon e më gjerë.

Metodat:

Metoda kualitative: duke përdorur burime teorike, shqyrtime të literaturës përkatëse për këtë çështje, artikuj shkencor, raporte të ndryshme, që kanë të bëjnë me këtë temë dhe hulumitme të ndryshme.

Metoda e analizës së përmbajtjes: duke marrë të dhëna, dokumente të ndryshme, shkrime të ndryshme me qëllim të analizimit të tyre sa më të mirë. Analizat e këtij studimi janë të bazuara në hulumtimet praktike dhe cilësore, të zhvilluara për qëllim të përshkrimit të zhvillimeve politike në Kosovë. Hartimi i temës i paraprin mendimeve personale si dhe nga intervistat gjysmë të strukturuar nga opinionistët politik dhe shkrimtarë politikë. Studimi u hartua duke u bazuar në disa tregues të ndarë në kategori: njohuritë dhe zhvillimet e politikës në Kosovë, angazhimet politike të Dr.Ibrahim Rugovës, efikasiteti i zgjedhjeve të tij dhe aktualiteti politik në Kosovë. Si dhe duke përdorur të dhëna sekondare, të dhëna nga hulumitmet paraprake, që kanë të bëjnë me këtë problem si dhe duke përdorur burime nga interneti, që janë kredibile për këtë punim.

5. PËRFUNDIME

Pas hulumtimeve të shumta dhe analizimit të materialeve të strukturuar të fushës përgjegjëse për këtë punim diplome, kemi arritur që të kuptojmë se shteti është një krijesë faktike, nevojë e patjetërsueshme e ekzistencës dhe e funksionimit të shoqërisë, e drejtë publike e cila duhet të jetë e mbështetur në rregulla dhe ligje, si dhe në përputhje me normën e të drejtës ndërkombëtare bashkëkohore, e cila përcakton infrastrukturën ligjore në kontekstin e krijimit të shteteve dhe njohjes së tyre në të drejtën ndërkombëtare. Gjatë këtij rrugëtimi rol kryesor dhe nismëtar i shtetndërtimit ishte Ibrahim Rugova. Si studiues i thellë i letërsisë e i kulturës shqiptare, Ibrahim Rugova ka lënë një trashëgimi, që rri në themelet e dijeve tona. Rugova dijetar u bë udhëheqësi i rezistencës së popullit shqiptar të Kosovës me organizim të pashembullt, që krijoi Lidhja Demokratike e Kosovës, që si Lidhja Shqiptare e Prizrenit, për të cilën ai ushqente dashuri të pashoqe – të ndërtonte, tani me sukses të fundmë, bazat e shtetit të ri ndërsa rezistonte okupimin serb. Ibrahim Rugova u bë burrshtetasi i parë i Kosovës, shenja mbrojtëse e shtetit në krye, të të cilit qëndroi edhe në kohën kur njihej, por nuk pranohej si i tillë. Në kohë të vështira, Rugova me organizimin më sistematik e të qëndrueshëm, që kishin ngritur shqiptarët në këto troje, me mekanizma institucionalë të votës demokratike, ndërtoi struktura të qëndrueshme të Republikës së Kosovës, që ishin pjesë e veçuar e rezistencës së organizuar kundër okupimit. Ai udhëhoqi një luftë popullore për pavarsinë, që avokoi një rezistencë paqësore ndaj sundimit jugosllav dhe lobi për mbështetje nga SHBA-të dhe Europa, veçanërisht gjatë Luftës së Kosovës: Veprimtaria e Rugovës, si studiues i letërsisë e i kulturës shqiptare, si mendimtar i rrallë, me një filozofi të veçantë politike, si lider e burrshtetas, të cilin e shquan urtësia dhe konsistenca, do të jetë objekt i studimeve të vazhdueshme në të ardhmen.. Ai theksoi fort trashëgimin e lashtë të Dardanisë, mbreterit e pavaruar dhe më vonë provincat e Perandorisë Romake që përfshin territorin e sotëm të Kosovës, për të forcuar identitetin e vendit dhe për të promovuar politikën e tij të marrëdhënieve të ngushta me Perëndimin. Për shkak të rolit të tij në historinë e Kosovës, Rugova është quajtur “Ati i Kombit” dhe “Gandi i Ballkanit”, ndërsa pas vdekjes është shpallur HEROI I KOSOVËS: Shtetndërtimi i Kosovës si proces tregon qartë njëjërën prej mënyrave apo tregimeve se si krijohet shteti në të drejtën ndërkombëtare, duke filluar nga gjeneza historike e popullit shqiptarë, marrë parasysh aspektin gjeografik, demografik, etnik, territorial, autoktonik, kushtetues e politik. Kosova duke sfiduar të drejtën ndërkombëtare, njëkohësisht sfidoi qytetërimet dhe shtetet

bashkësisë ndërkombëtare, të cilat duke qenë përballë një dehumanizmi u detyruan që të shndërroheshin në mbrojtjës të së drejtës publike, ku me ç' rast u bënë pjesë aktive e garantimit të lirive njerëzore, rrjedhimisht e krijimit të shtetit të Kosovës, si një e drejtë e mohuar ndër vite përballë të drejtës publike bashkëkohore ndërkombëtare. Duke qenë se e drejta ndërkombëtare nuk krijon shtete, por i pranon ato si ekzistenca dhe fakte, kemi konstatuar se shtetet e posaçërisht ndikimi i fuqive të mëdha dhe interesave të tyre strategjike janë vendimtare në sigurinë dhe zbatueshmërinë e saj si normë ndërkombëtare. Njëherësh, vetëvendosja dhe hyrja e saj si parim në zbatim kontribuoi në të drejtën e popujve për të zgjedhur pushtetet e tyre vetëqeverisëse, pse jo në variantin tjetër edhe të krijimit të shteteve, e cila si ide liberale, parim e përmbajtje kishte për qëllim, që të zgjidheshin shumë probleme, të cilat dikur kishin derivuar në dhunë, konflikte e luftëra të ndryshme mes popujve dhe vet shteteve brendapërbrenda tyre, për shkakun e dominimit të etnive mbi njëra tjetrën. Kosova demonstroi faktin se, krijimi i shtetit është më shumë sesa shprehje e dëshirës, në këtë kuptim e drejta ndërkombëtare është interpretuar edhe në bazë të interesave të fuqive të mëdha si përcaktuese të proceseve që lidhen me shtetin dhe krijimin e tij. Në kontekst të pohimit hipotetik se shtetet krijohen në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, Kosova është rasti konkret i realizimit të shtetësisë së saj në përputhje me parimet bazë të vetëvendosjes dhe të drejtës ndërkombëtare si rast unik i trajtimit, e cila demonstroi dhe dëshmoi të gjitha atributet dhe kriteret e një shteti të pranuar. Nga i gjithi punimi më lart mund të potencoi se Ibrahim Rugova është shembull që duhet të ndjeket edhe nga politikant e tanishme. Si një ndër shembujt që duhet të ndjeket nga ai është marrëdhënia dhe dija diplomatike me SHBA-në dhe BE-në.

BIBLIOGRAFIA

Literatura e shfrytëzuar:

1. *Ferja, Hysamedin: Shkenca Politike, Tiranë: Pegi 2004, ISBN: 99943-638-3-2*
2. *Krasniqi, Milazim: Sekrete qe nuk i mori me vete Ibrahim Rugova, Kosova Pen Center-2017*
3. *Bytyqi, Enver: Filozofia politike nacionale e Ibrahim Rugovës, Faik Konica, Prishtinë Koha-Tiranë 2010*
4. *Nurboja, Reshat: Çështjet e Kosovës dhe Diplomacia ndërkombëtare 1990-2010, Tiranë 2018*
Keka, Gjon: Ibrahim Rugova Lidërsip i idealve te medha, Botart-Skopje 2011, ISBN:9789928116123

Materiale nga interneti:

5. *ASSEMBLY SUPPORT INITIATIVE: Dr.Ibrahim Rugova-A man with the power to unite, 2006*
6. *Hamiti, Sabri: Momento per Rugoven, 2013*
7. *Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave – KIPRED 2015*
8. *Harapi, Anton: Mishërimi i hirit të zotit dhe dashurisë kombëtare, 2018 - Arbresh.info*
9. <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/4634562.stm>
10. <https://balkaninsight.com/2020/01/21/ibrahim-rugova-babai-pacifist-i-pavaresise-se-kosoves/?lang=sq>
11. <http://multi-perspektiva.com/15-demonstratat-1968-kushtetuta-1974-demonstratat-1981/>
12. <https://president-ksgov.net/?id=50,98,98,98,a,,>
13. <https://web.archive.org/web/20071228193620/http://www.balkaninsight.com/en/main/news/7145>
14. <https://www.rks-gov.net/AL/f138/infrastruktura/legjislacioni>
15. <https://web.archive.org/web/20070209014848/http://www.kosova.com/artikulli/29107>,
16. http://www.kipred.org/repository/docs/Kosovo_national_study_albanian_139348.pdf

17. <http://kosovoabc.com/sistemi-politik--marredheniet-nderkombetare/>
18. <http://www.iseal.ch/wp-content/uploads/2019/Mar/Kosova.pdf>
19. <https://web.archive.org/web/20070810204803/http://www.kosova.com/artikulli/29105>
20. <https://dardaniapress.com/filozofia-dhe-politika-sipas-dr-ibrahim-rugoves/>
21. <http://illyriapress.com/filozofia-dhe-politika-sipas-dr-ibrahim-rugoves/>